



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

Nr. 306/prot.

Tiranë, më 20.03.2025

5

VENDIM

Nr. 1164, Datë 20.03. 2025

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT
TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ORBICO UKRAINE NGA SHOQËRIA PRIVATE
JOINT – STOCK COMPANY SAV ORBICO”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.03. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ORBICO UKRAINE nga shoqëria PRIVATE JOINT – STOCK COMPANY SAV ORBICO.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë ORBICO UKRAINE nga shoqëria PRIVATE JOINT – STOCK COMPANY SAV ORBICO,

VËREN SE :

1. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë ORBICO UKRAINE nga shoqëria PRIVATE JOINT – STOCK COMPANY SAV ORBICO.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për shitjen dhe blerjen e interesit aksionar në kapitalin themeltar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ORBICO UKRAINE”, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: PRIVATE JOINT – STOCK COMPANY SAV ORBICO është një shoqëri private aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Ukrainës, me objekt aktiviteti: tregti me shumicë jo e specializuar; tregtimi dhe mirëmbajtja e makinave dhe mjeteve motorike të pasagjerëve; aktivitetet ndërmjetësuese në tregtinë e ushqimeve, pijeve dhe produkteve të duhanit; tregti me shumicë e pijeve, sheqerit, çokollatës dhe ëmbëlsirave; tregti me shumicë e kafesë, çajit, kakaos dhe erëzave, etj.

PRIVATE JOINT – STOCK COMPANY SAV ORBICO zotërohet me kontroll të përbashkët nga Orbico d.o.o me 51% dhe nga Asnova Holding me 49%¹.

Asnova Holding është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Ukrainës, me objekt aktiviteti: ofrimi i shërbimeve të tjera financiare (me përjashtim të: sigurimit dhe sigurimit pensional), tregtimi i automjeteve dhe makinave, marrja me qira e makinave dhe pajisjeve për zyra, përfshirë kompjuterët, tregti me shumicë e paspecifikuar, konsulencë biznesi dhe menaxhimi, etj.

Orbico d.o.o. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kroacisë, e specializuar në shërbimet e shpërndarjes dhe furnizimit, duke mbuluar një gamë të gjerë produktesh të njohura globalisht, përfshirë mallrat e konsumit të shpejtë (FMCG), produkte të bukurisë, duhanit, farmaceutikës, elektronikës, pajisjet shtëpiake dhe produktet automobilistike.

Shoqëria Orbico d.o.o. zotëron 100% shoqërinë *ORBICO SHPK*, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: tregtim artikujsh industrial, import dhe eksport me shumicë dhe pakicë pijesh alkoolike, duhan, cigare, produkte kozmetike, karburante të ndryshme, vajra lubrifikantë, etj.

Target: ORBICO UKRAINE është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Ukrainës, e cila ka si objekt kryesor të aktivitetit të saj shitjen me shumicë të parfumeve dhe produkteve kozmetike. ORBICO UKRAINE e operon biznesin e saj vetëm në tregun e Ukrainës.

ORBICO UKRAINE zotërohet 100% nga Orbico d.o.o.

Target nuk ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri.

2. Transaksioni

Më datë _____ pala blerëse PRIVATE JOINT – STOCK COMPANY SAV ORBICO dhe pala shitëse Orbico d.o.o. kanë nënshkruar “Marrëveshje për shitjen dhe blerjen e interesit aksionar në kapitalin themeltar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ORBICO UKRAINE”.

Referuar kësaj marrëveshje, pala shitëse shet dhe ia transferon palës blerëse Interesin Aksionar të çliruar nga të gjitha barrët, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje. Pronësia e

¹ Ky transaksion është autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 1046, datë 16.01.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët, nëpërmjet blerjes së aksioneve, të shoqërisë “SAV ORBICO” nga shoqëritë Orbico d.o.o. dhe Asnova Holding”.

Interesit Aksionar i kalon palës blerëse që nga momenti i nënshkrimit nga pala shitëse i *Aktit të Transferimit dhe Pranimit të Interesit Aksionar* në kapitalin themeltar të shoqërisë target ORBICO UKRAINE. Palët do të nënshkruajnë Aktin e Transferimit dhe Pranimit të Interesit Aksionar në Datën e Finalizimit.

Në përfundim të transaksionit, ORBICO UKRAINE do të zotërohet 100% nga PRIVATE JOINT – STOCK COMPANY SAV ORBICO. Ky transaksion përbën një ndryshim kontrolli, pasi kontrolli i drejtpërdrejtë i shoqërisë target zhvendoset nga një njësi e vetme (Orbico d.o.o.) në një strukturë të përbashkët kontrolli, që përfshin Orbico d.o.o. dhe Asnova Holding (nëpërmjet PRIVATE JOINT – STOCK COMPANY SAV ORBICO).

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të ORBICO UKRAINE nga shoqëria PRIVATE JOINT – STOCK COMPANY SAV ORBICO, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

3. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shitjes me shumicë të produkteve të konsumit të shpejtë dhe i produkteve kozmetike dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë ORBICO UKRAINE nga shoqëria PRIVATE JOINT – STOCK COMPANY SAV ORBICO.

ORBICO d.o.o. është një shoqëri aktive kryesisht në shitjen dhe distribucionin e produkteve kozmetike, ushqimore dhe jo ushqimore, farmaceutike, tekstile, etj. dhe është prezente në Shqipëri nëpërmjet ORBICO SHPK. ORBICO SHPK operon kryesisht në tregun e produkteve të konsumit të shpejtë (FMCG) dhe tregun e bukurisë në vend, por pjesa që zë Orbico SHPK në totalin e tregut të produkteve të konsumit të shpejtë (FMCG) është rreth 1%.

Shoqëria ORBICO UKRAINE ushtron aktivitetin e saj në tregun e shitjes me shumicë të parfumeve dhe produkteve kozmetike, por vetëm në Ukrainë.

Për sa më sipër, përqendrimi i njoftuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese pasi nuk do të krijohet mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ORBICO UKRAINE nga shoqëria PRIVATE JOINT – STOCK COMPANY SAV ORBICO.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS


Leida MATJA

()
Zv/Kryetar


Rezana KONOMI

()
Anëtar

Durim KRAJA

()
Anëtar

Fatjola DELIJA

()
Anëtar

Denar BIBA

()
Kryetar

